



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0662

Paditësi/Ankuesi

G H, Prizren.

kundër

E paditura

NSH "NGLB Kosova" Prizren (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1035 të datës 21 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1035 i datës 21 tetor 2022.**
- 3. Lënda dërgohet në rigjykim në Shkallë të parë tek gjyqtari përkatës i DHPGJSK-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 24 qershor 2013, paditësi dorëzoi një ankesë në DHPGJS kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. PRZ029-0193, të datës 28 maj 2013 me të cilën ishte refuzuar kërkesa për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 541.36 euro nga NSH, "NGLB Kosova" në likuidim Prizren. Paditësi në ankesën e parashtruar nuk e ka bashkangjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit të cilin e atakon.

Më 23 tetor 2013, gjykata kishte lëshuar urdhër për paditësin, me të cilin ka kërkuar që brenda 15 ditësh, paditësi të parashtojë kopjen e vendimit të AKP-së kundër të cilit është ushtruar padia. Po ashtu, paditësi është njoftuar se nëse nuk e dorëzon vendimin e kundërshtuar atëherë padia e tij do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Me 29 shtator 2018, e paditura ka parashtruar mbrojtje në ankesë dhe e ka kundërshtuara ankesën e paditësit si të pabazuar. Ka propozuara që gjykata ta refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL nr. PRZ029-0193.

Me 21 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ma Aktvendimin C-IV-13-1035, e ka hedhë poshtë si të pa pranueshme ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.

Në arsyetim të këtij Aktvendimi thuhet se duke u bazuar në nenin 74.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se: Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i autoritetit të likuidimit mund të kundërshtojë vendimin e tillë duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve par pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit. Ankesa e këtillë duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi. Tutje ka arsyetuar se nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër

të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaje një kërkesë apo ankesë.

Duke u bazuar në shtojcën e ligjit NR.04/L033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenin 25,27,28 të njëjtit, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave gjykata vjen në përfundim se ankesa duhet të dorëzohet në gjykatë së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimit të vendimit. Në këtë mënyrë, dorëzimi i vendimit të atakuar nga ankuesi është një kriter i provueshmërisë së ankesës, përkatësisht mosdorëzimi i këtij vendimi nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të pa pranueshme. Po ashtu në aktvendim është konstatuar se, gjykata i ofroi edhe një mundësi paditësit ta plotësuar këtë kusht të pranueshmërisë ashtu që nëpërmjet urdhrit të saj të datës 23 tetor 2013, i kërkoi dorëzimin e vendimit të atakuar të Autoritetit Likuidimit, brenda afatit të përcaktuar në atë urdhër. Nga zyrtari i postës është konstatuar se urdhri është pranuar nga paditësi më 29 tetor 2013, por paditësi nuk e ka dorëzuar urdhrin e kundërshtuar të AL-së.

Më 09 nëntor 2022, nëpërmjet postës paditësi/ankuesi e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-13-1035 të datës 21 tetor 2022. Paditësi me ankesë kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar, të aprovohet padia si e bazuar, dhe të detyrohet e paditura të ia paguajë shumën prej 541.36 euro, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për shkak të ndërprerjes të parakohshme të Kontratës mbi punën, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e pagave gjer në pagesën përfundimtare, dhe këtë me likuidim-pagesë të borxhit nga Fondi Monetar i AKP-së (Fondi i 80%), i grumbulluar nga shitja asetve-Masës së likuidimit të NSH NGLB Kosova në Likuidim, me seli në Prizren. Ose të marrë aktvendim për kthim në gjendjen e mëparshme, dhe që Lëndën të ia kthej Organit të shkallës së parë të DHPGJS-së, për të vendosur në mënyrë meritore sipas Ankesës të paditësit, të datës 26 qershor 2013, pasi paditësi tani ka plotësuar kushtin formal dhe kësaj ankese ia bashkëngjiti Vendimin e

autoritetit për likuidim NSH NGLB Kosova, PRZ029-0193, të datës 28 maj 2013, mos prezantimi i të cilës ka ndodhë ka ndodhur pa fajin e paditësit.

Paditës/ankuesi në ankesën e parashtruar thekson se aktvendimi i atakuar me këtë ankesë është i pa bazuar për shkaqet e përmendura në ankesën-padinë e paditësit të datës 26 qershor 2013 e cila gjendet në shkresat e lëndës, si dhe për këto shkaqe: Ankuesi thekson se është person i verbër dhe person i hendikepuar, fakt ky që vërtetohet me shikimin-leximin e Librezës të Verbërisë, Nr.542, të lëshuar sipas Vendimit nr.1601 nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Pensione në Prishtinë, e cila i bashkëngjitet si dëshmi kësaj ankese si provë e ka bashkëngjitur: Librezën e verbërisë së paditësit, Nr.542, të lëshuar sipas Vendimit nr.1601 nga ana e ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Pensione në Prishtinë. Paditësi tutje thekson se si person i verbër e që është për shkaqe objektive nuk ka mundur të përpilon vet ankesën, kështu në atë kohë ankesën kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit e kanë përpiluar shokët e tij, të cilët si palë të pa nxëna nuk kanë qenë në dijeni së bashku me Ankesë në Dhomën e Posaçme ka qenë dashur të dorëzohet edhe Vendimi i kundër të cilit është parashtruar ankesa, pasi po të kishin qenë në dijeni do ta kishin dorëzuar në atë kohë në Dhomën e Posaçme bashkë me ankesë.

Paditësi thekson se për Urdhrin e Gjykatës, të datës 23 tetor 2013, dhe për detyrimin e dërgimit të vendimit të lartpërmendur të Autoritetit të Likuidimit bashkë me Ankesë, është ven në dijeni tek tani kur e ka pranuar aktvendimin e atakuar me këtë ankesë, të cilin ia kishte lexuar një avokat në Prizren, bazuar në faktin se paditësit në atë nuk i është dorëzuar në mënyrë të rregullt, ashtu siç parashihet dorëzimi për personat e verbër, pasi po të ishte dorëzuar, paditësi/ do ta dërgonte në Dhomën e Posaçme Vendimin e autoritetit të Likuidimit, të datës 28 maj 2013, sipas urdhrin të Gjykatës të datës 23 tetor 2013, rrethanë kjo e bënë të pa bazuar aktvendimin e atakuar me këtë ankesë, dhe e imponon nevojën për kthim në gjendje të mëparshme, respektivisht për kthim të lëndës tek Organi i shkallës së parë për rishqyrtim dhe vendosje meritore.

Paditësi shton se e paditura i'a ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme marrëdhënien e punës para skadimit të afatit, pa njoftim paraprak me shkrim, edhe pse sipas ligjit në fuqi në atë kohë, e paditura ka pasur detyrim që ta njoftojë me shkrim paraprakisht nëse ankuesi i ndërpritet marrëdhënia e punës para skadimit të Kontratës mbi punën. Tutje paditësi konsideron se nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se gjëja paditësi ka qenë punëtor aktiv në NSH "NGLB Kosova", pasi që ai gjithnjë ka qenë në dispozicion për të, ku edhe ka punuar kohë pas kohe, varësisht nga kërkesat për punë që janë paraqiture në NSH "NGLB Kosova", dhe nuk është faji i tij që punëdhënësi i tij (këtu NSH NGLB Kosova) nuk ka qenë në gjendje të sigurojë punë për të punësuarit e saj. Po ashtu ankuesi thotë se është jo kontestuese fakti se NSH "NGLB Kosova" asnjëherë nuk i ka kundërshtuar kërkesat e tij, por edhe të punësuarve tjerë, për kompensimin e pagave të pa paguara do të paguhen nga Fondi i shitjes së aseteve të NSH "NGLB Kosova". Ankuesi/paditësi anekses i ka bashkangjitur në kopje Librezën e Verbërisë nr.542 dhe vendimin e kundërshtuar të AL.

Me 19 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se qëndrimin e saj lidhur me argumentet e Ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht i sqaruar në Mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me nr.C-IV.-13-1035 të DHPGJS, pranë shkallës së I-re Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më parë do të ishin të pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtare i parashtron Kolegjit të ankesave që t'i referohet Mbrojtjes së aktvendimit përkatës.

AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të

Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj si i tillë duhet të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, marrë Aktvendimin C-IV-13-1035, me të cilën e ka hedhë poshtë si të pa pranueshme, ankesën e parashtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, pasi që paditësi ankesës nuk ja kishte bashkangjitur Vendimin e kundërshtuara të AL edhe pas urdhrit të Gjykatës. Me këtë rast ankuesi nuk i kishte plotësuar kriterin e pranueshmëris që përshihen me nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisja e procedurave në Dhomën e Posaçme. Shkalla e I-të e DHPGJS e kishte bazuar Aktvendimin e saj edhe në shtojcën e ligjit NR.04/L033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenin 25,27,28 të njëjtit, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës. Pra Shkalla e I-rë krejt në fund kishte konstatuar se ankesa e ishte pa pranueshme në bazë me dispozitës së nenit 36 të Ligjit për DHPGJS.

Paditësi/Ankuesi nuk pajtohet me Aktvendimin përkatësisht konstatimin e Shkallës së I-rë, për shkak se është person i verbër dhe person i hendikepuar, fakt ky që vërtetohet me shikimin-leximin e Librezës të Verbërisë, Nr.542, të lëshuar sipas Vendimit nr.1601 nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Pensione në Prishtinë, e cila i bashkëngjitet si dëshmi kësaj ankese si provë e ka bashkangjitur: Librezën e verbërisë së paditësit, Nr.542, të lëshuar sipas Vendimit nr.1601 nga ana e ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Pensione në Prishtinë. Tutje në ankesë ka theksuar se si person i verbër që është për shkaqe objektive nuk ka mundur të përpilon vet ankesën e paraqitur në Shkallë te I-rë, kështu në atë kohë ankesën kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të datës 28 maj 2013 e

kanë përpiluar shokët e tij, të cilët si palë të pa "nxëna" nuk kanë qenë në dijeni që së bashku me Ankesë në Dhomën e Posaçme ka qenë dashur të dorëzohet edhe Vendimi i kundër të cilit është parashtruar ankesa, pasi po të kishin qenë në dijeni do ta kishin dorëzuar në atë kohë në Dhomën e Posaçme bashkë me ankesë.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet e palëve, dhe analizoi në detaje shkresat e lëndës erdhi në përfundim se pretendimet e paditësit/ankuesit janë të bazuara.

Kolegji i Apelit verën se Paditësi/ankuesi është person i verbër i cili fakt vërtetohet edhe nga Libreza e verbërisë së paditësit, Nr.542, e lëshuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Pensione në Prishtinë dhe nga vërtetimi i leshura nga Shqota Ndrëkomunale e të Verbërve dt. 08 nëntor 2013, të cilën paditësi i ka dorëzuar në Shkallë të I-rë dhe të II-të.

Po ashtu Kolegji i Apelit vëren se urdhri i shkallës së I-rë me të cilin i është kërkuar dorëzimi i Aktvendimit të kundërshtuar siç duket nuk është pranuar nga personi i njëjtë që e ka nënshkruar ankesën ndaj vendimit të kundërshtuar të AL, me meqë në fletë kthesën tek rubrika marrësi është venë shenja e gishtit dhe është shënuar se nuk din shkrim. Po ashtu edhe ankesa e paraqitur kundër aktvendimit të kundërshtuar të Shkallës së I-rë është nënshkruar nga paditësi. Nga këto arsye Kolegji i apelit vlerëson se janë të bazuar pretendimet e paditësit lidhur me atë se i njëjti nuk ka pasur njohuri për vendimin e kundërshtuar i cili është dashur të dorëzohet Gjykatës, pasi siç duket i njëjti nuk ka qenë i informuara se duhet dorëzohet vendimi i kundërshtuar i AL. Andaj duke marrë parasysh këto rrethana dhe gjendjen e hendikepuar të paditësit se është person i verbër, Kolegji i Apelit konsideron se të njëjtit duhet të jepet edhe një mundësi nga shkalla e I-rë që në rigjykim të kërkohej njoftimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punë N.SH-së "NGLB" Kosova" Prizren, apo të kërkohej dëshmi tjera dhe pas vlerësimit të tyre Shkalla parë të vendos në merita.

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë me rastin e vendosjes lidhur me pranueshmerin e ankesës së paditësit është dashur të ketë parasysh gjendjen e

hendikepuar të paditësit, në atë mënyrë që të sigurohet që urdhri paditësit të i jetë dorëzuar personalisht, pasi që i njëjti është person i verbër dhe ka mundësi që të mos informohet nga personat tjerë.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësit është e bazuar mbi arsyet e cekura më lartë dhe Aktvendimi i ankimuar nuk është i drejtë e si i tillë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim në Shkallë të I-rë tek Gjyqtari përkatës.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që ankesa e paditësit është nën shumën prej 1.000,00 euro, bazuar në nenin 13.9 të Udhëzimit administrativ nr.01/2017 të datës 22 mars 2017, për unifikimin e Taksave Gjyqësore, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21 mars 2024.

Mr.Sc, Sahit Sylejamani Gjyqtar kryesues
